

SHQIPËRIA DHE BASHKIMI EVROPIAN:

NUK ËSHTË KOHA PËR T'U DISTANCUAR NGA QASJA 'E KAROTËS DHE SHKOPIT'

Gjergji Vurmo*, Corina Stratulat**

TË DIELËN e shkuar, kryetari i Partisë Socialiste Edi Rama u betua si kryeministri i ri i Shqipërisë pas fitores bindëse të koalicionit të kryesuar prej partisë së tij në zgjedhjet parlamentare të qershorit (83 mandate) kundrejt koalicionit të kryesuar nga Sali Berisha dhe Partia Demokratike (57 mandate). Vendosja e Ramës si kryeministër përfundon ciklin tetëvjeçar të udhëheqjes së kundërshtarit të tij Berisha, i cili do të jetë në rolin e këshilltarit në të ardhmen nën udhëheqjen e kryetarit të ri të PD-së Lulzim Basha. Po ashtu, rotacioni shënon zgjidhjen paqësore të një rivaliteti politik të ashpër dhe konfliktual, i cili ka penguar prej një kohe të gjatë ecurinë e agjendës së reformave të Shqipërisë si dhe rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian (BE).

Tranzicioni i butë i pushteteve së bashku me përpjekjet e fundit të Shqipërisë për të plotësuar kriteret e BE-së duhet të kontribuojë për ri-dimensionimin dhe rritjen e nivelit të marrëdhënieve me BE-në. Për të përmbushur pjesën e tij të marrëveshjes, Brukseli duhet që sipas parimit të reciprocitetit t'i japi Shqipërisë shpërblimin e pritur të 'statusit të vendit kandidat' në fund të vitit si edhe të ushtrojë një kondicionalitet të përcaktuar më mirë e më qartë.

Statusi i vendit kandidat: një 'karotë' e merituar...

PAS DY JO-ve të njëpasnjëshme dhe të qarta ndaj aplikimit të Shqipërisë në vitet 2010 dhe 2011, Komisioni ka rekomanduar në tetorin e kaluar marrjen e kushtëzuar të statusit të kandidatit nga Shqipëria me kusht që vendi të miratonte ligjet e mbetura pezull në fushat e drejtësisë, administratës

publike dhe rregullore të Kuvendit. Zhvillimi i zgjedhjeve parlamentare të rregullta gjatë këtij viti –në një vend ku çdo garë zgjedhore që prej vitit 1992 ka dështuar të përmbushë standardet më të larta ndërkombëtare– u shndërrua në një tjetër sprovë përmes së cilës Shqipëria pritej të kalonte për të treguar pjekurinë e saj politike dhe për të ecur më tej në rrugën e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Vendi përmbushi paketën e mbetur të reformave në muajin maj dhe pavarësisht një fillimi të vështirë duke përfshirë edhe problemet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kaloi me sukses edhe sprovën e zgjedhjeve parlamentare të qershorit. Këto zhvillime e çojnë Shqipërinë drejt përmbushjes së kërkesave të vendosura prej ekzekutivit të Brukselit për marrjen e statusit të vendit kandidat si edhe sjellin përmbushjen e gjysmës së 12 prioritetëve të theksuara prej Komisionit Evropian në nëntor të vitit 2010. Referuar gjysmës së parë të kësaj liste 'të detyrave të shtëpisë' Shqipëria ka zgjedhur Avokatin e Popullit (dhjetor 2011), ka miratuar ligjin për krijimin e gjykatave administrative (maj 2012) dhe ka kryer ndryshimet e nevojshme të Kushtetutës për heqjen e imunitetit të deputetëve (shtator 2012). Si rrjedhojë mund të thuhet se 'masa kritike e rezultateve' e kërkuar nga BE është përmbushur dhe tashmë topi është në fushën e kësaj të fundit.

Në përgjigje të sa më sipër, Komisioni Evropian duhet të respektojë vullnetin e tij dhe të rekomandojë gjatë kësaj vjeshte që Këshilli t'i japë Shqipërisë deri në fund të këtij viti dritën jeshile për t'u bërë vend kandidat. Devijimi nga dhënia e kësaj 'karote' të shumëpritur Shqipërisë do të dëmtonte besueshmërinë e procesit. Forca ndikuese e BE-së

Ky komentari u përgatit nga Gjergji Vurmo (IDM) dhe Corina Stratulat (EPC). Kontributi i IDM në përgatitjen e këtij dokumenti u mundësua me mbështetjen e OSI Think Tank Fund.

qëndron pikërisht tek besueshmëria e saj. Nëse kjo e fundit kompromentohet, atëherë të njëjtin fat do të ketë edhe perspektiva e procesit të reformave në Shqipëri. Pra, nëse vazhdohet 'të fitohet kohë' do të dëmtohet kapitali i besueshmërisë së BE-së, por, në të njëjtën kohë, kjo do të ishte një shuplakë e fortë ndaj përpjekjeve për të mbajtur një rritëm të kënaqshëm reformash në vend.

Duke pasur parasysh ndryshimet e qeverisë në Shqipëri, stimuli për 'statusin e vendit kandidat' do të lejonte udhëheqjen e re që të fillonte me këmbë të mbarë në sytë e elektoratit. Gjithashtu, kjo do të siguronte angazhimin e vendit në procesin e integritimit në një moment kur një vullnet i tillë është thelbësor për të përfunduar punën e mbetur dhe veçanërisht për të vazhduar me zbatimin e reformave të miratuara tashmë. Në fakt, një kapitull i ri i marrëdhënieve Shqipëri-BE, i cili do të mund të hapet me dhënien e statusit kandidat, do të korrespondonte më së miri me trajtimin e sfidave të mbetura nga lista e 12 prioritetëve kryesorë, që lidhen më së shumti me nevojën për t'u siguruar se reformat ndodhin jo vetëm në letër por edhe në praktikë.

...shërbehet më mirë me një 'shkop' më të mprehtë

NËSE VENDI do të përfshihej në përgatitjet për fillimin e negociatave për anëtarësim, më tepër sesa një mjet efikas për të shmangur lodhjen nga transformimi, 'statusi i vendit kandidat' do t'i jepte BE-së mundësinë për të ri-shikuar dhe përditësuar listën e prioritetëve për Shqipërinë në mënyrë që të reflektonte një balancë më të mirë ndërmjet qartësisë dhe qëllimit të kushteve të vendosura.

Gjashtë prioritetet e mbetura –forcimi i shtetit ligjor, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut – janë të gjitha çështje thelbësore të mirëqeverisjes si edhe kushte përmbajtësore në përputhje me standardet dhe vlerat themeluese të BE-së. Ato janë gjithashtu fusha të rëndësishme reformash për qytetarët shqiptarë, të cilët nëpërmjet votës së qershorit sinjalizuan një dëshirë për ndryshim që ata e presin prej qeverisë së re dhe të cilët, sipas Transparency International, mbeten thellësisht dyshues kundrejt udhëheqësve të tyre politikë.

Por që këto 'pikëpyetje të mëdha' të bëjnë ndryshimin në terren dhe të transformohen në më shumë sesa thjesht procedura formale për miratimin e ligjeve dhe të masave përkatëse, ato duhen përkthyer në detyra konkrete dhe të matshme, të cilat mund të kontribuojnë në mënyrë efektive për arritjen e objektivit të përgjithshëm. Pavarësisht qëllimit fisnik, nuk mund të pritët që kërkesa të vagullta dhe të përgjithshme, të mbështetura nga plane veprimi që nuk adresojnë sistematikisht dhe qartësisht rrënjët e problemeve në këto fusha, të kenë ndikim real dhe afatgjatë.

Për këtë arsye është thelbësish e rëndësishme që Komisioni dhe qeveria e re e Shqipërisë t'u kushtojnë më shumë vëmendje hartimit të standardeve dhe instrumenteve përmes të cilave do të gjykohej progresi në secilin prej prioritetëve të mbetura si edhe që secila prej reformave të miratuara dhe politikave të reja t'i nënshtrohet procesit të kontrollit (screening). Kjo nuk do të thotë që lista e kërkesave të zgjerohet. Përkundrazi, kjo nënkupton se duhet të ketë më tepër qartësi dhe një kontroll më të lartë të cilësisë së progresit të Shqipërisë në përmbushjen e prioritetëve të veçanta.

Në kuadër të kësaj strategjie, Komisioni duhet t'i kërkojë Shqipërisë edhe forcimin e dialogut me shoqërinë civile dhe jo vetëm dialogun 'politik'. Pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile në procesin e anëtarësimit të vendit të tyre që në fillimin e tij do të mund të përmirësonte cilësinë dhe rezultatet e reformat të nevojshme. Po ashtu, kjo do të ndihmonte për përmirësimin e kapaciteteve të shoqërisë civile dhe për krijimin e terrenit të përshtatshëm për një ndërveprim efikas ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë që, duke pasur parasysh dhe eksperiencën malazeze, do të ishte thelbësor kur Shqipëria të jetë gati për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE. Me këtë synim, Brukseli duhet të nxitë Shqipërinë që të ecë me të njëjtin hap me vendet pararojë në rajonin e Ballkanit duke krijuar struktura konsultative të përbashkëta dhe procedura që bëjnë të detyrueshme përfshirjen e shoqërisë civile në të gjithë nivelet e proceseve politikëbërëse dhe ligjvënëse.

Rasti i Shqipërisë nxjerr në pah aktualisht faktin se për të mbajtur 'topin e zgjerimit në lëvizje' nevojitet një përfshirje reale si nga vendet aspirante për anëtarësim të Ballkanit Perëndimor ashtu edhe nga vetë BE. Politika e 'karotës dhe shkopit' mbetet një qasje e provuar dhe e testuar. Pra, a do t'i përmbahet BE-ja pjesës së saj të marrëveshjes?

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM (IDM)

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) është një organizatë e pavarur jo qeveritare, themeluar në nëntor 1999 në Tiranë, Shqipëri. Ajo punon për të forcuar shoqërinë civile në Shqipëri, për monitorimin, analizimin dhe lehtësimin e proceseve Euro-Atlantike të vendit si dhe për të ndihmuar konsolidimin e qeverisjes së mirë dhe të politikëbërjes gjithëpërfshirëse në vend. IDM-ja ndërmerr objektivat e saj me anë të ekspertizës, studimeve inovative mbi politikat, analizat dhe opsionet politike që bazohen në veprim.

QENDRA PËR ÇËSHTJE EVROPIANE DHE TË SIGURISË (CESA)

Qendra për Çështje Evropiane dhe të Sigurisë (CESA) përfaqëson departamentin e specializuar të Institutit në fushat e çështjeve të sigurisë dhe atyre Evropiane. Misioni i saj është të avancojë studimet evropiane dhe ato të sigurisë si dhe kërkimet dhe analizat që lidhen me proceset kryesore reformues në këto fusha duke inkurajuar kështu debatin e informuar dhe përmirësimin e këtyre proceseve. Qendra i kushton vëmendje të veçantë përpjekjeve kombëtare dhe iniciativave rajonale duke synuar zhvillimin e kapaciteteve institucionale të qëndrueshëm dhe të burimeve njerëzore cilësore që do të shërbejnë për përballjen me sfidat bashkëkohore për reformë, proceset integruar dhe të bashkëpunimit nëpërmjet një qasjeje edukative dhe të orientuar drejt zgjidhjes së problemeve.

QENDRA E POLITIKAVE EVROPIANE

Qendra e Politikave Evropiane (www.epc.eu) është një think tank jo-fitimprurës i pavaruar, i angazhuar në funksion të integritetit evropian. EPC fokusohet në nivelet më të avancuara të politikëbërjes evropiane dhe globale duke u ofruar anëtarëve të vet dhe publikut të gjerë informacion dhe analiza të shpejta dhe cilësore mbi axhendën e politikave globale dhe të BE-së.

FONDI THINK TANK I OSI

Fondi Think Tank i OSI (<http://www.soros.org/initiatives/thinktank>) mbështet qendrat e pavarura të analizës së politikave, të cilat ndihmojnë në forcimin e demokracisë nëpërmjet identifikimit dhe analizimit të alternativave të politikave, advokimit të tyre dhe konsultimit me qeveritë. Fondi ofron mbështetje institucionale dhe financim të projekteve në mbi 20 vende të Evropës Qendrore e Juglindore dhe Kaukazit jugor.

Mbi autorët:

- * **Gjergji Vurmo** është Drejtor Programi i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (Tiranë).
- ** **Corina Stratulat** është analiste politikash në Qendrën e Politikave Evropiane (Bruksel).